

Marreveshje Bashkëpunimi
midis
AGJENCIA KOMBËTARE PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE (ALCIRT)
dhe
AUTORITETIT TË KOMUNIKIME E ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Këtej e tutje, Palët,

Të Vetëdijshme për rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional për të përmirësuar aftësitë mbrojtëse nëpërmjet shkëmbimit reciprok të informacionit mbi mbrojtjen kibernetike; dhe

Të Bindur që ky bashkëpunim i ndërsjelltë do të rezultojë në një kontribut të efektshëm në këtë fushë;

Me Dëshirën E Mire për të kontribuar në bashkëpunimin nëpërmjet zhvillimit të marrëdhënieve ndërmjet dy institucioneve;

Duke Deklaruar gadishmërinë e tyre në ndërmarrjen e aktiviteteve në kuadër të harmonizimit të legjisllacionit dhe të zgjerimit të bashkëpunimit të tyre të ndërsjelltë në fusha me interes të përbashket, duke krijuar kështu një kuadër dhe mjedis mbështetës bazuar në barazi, mosdiskriminim, dhe në një baraspëshë të të drejtave dhe detyrimeve;

Duke Riafirmuar vendoshmërinë e tyre për të kontribuar në mënyrë konstruktive dhe thelbësore në procesin zbatimit të legjisllacionit respektiv të dy institucioneve;

Kanë Vendosur, në ndjekje të këtyre objektivave, të konkludojnë Marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1
Qellimi

Palët do të bashkëpunojnë me qëllim zbatimin e Ligjit Nr.9918, datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" Vendimin Nr.766, datë 14.9.2011 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT)" si dhe rekomandimeve të BE-së për fushën, për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjelltë të dy palëve.

Neni 2
Parimet dhe vlerat e bashkëpunimit

Të dy institucionet konfirmojnë që ndajnë të njëjtin qëndrim për sa i perket mbrojtjes kibernetike. Dy institucionet angazhohen të punojnë mbi parimin e reciproritetit për të asistuar, bashkëpunuar, në fushën e mbrojtjes kibernetike, në komunikimet elektronike.

Neni 3 Angazhimet e palëve

Agjencia Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare angazhohen që;

- Të bashkëpunojnë në hartimin e dokumenteve rregullatore për mbrojtjen kibernetike në komunikimet elektronike.
- Të bashkëpunojnë në hartimin e dokumenteve rregullatore për sigurinë kibernetike në komunikimet elektronike.
- Të bashkëpunojnë për të shkëmbyer informacionin që palët kërkojnë për përmbushjen e detyrave që i ngarkon ligji përkatës.
- Të bashkëpunojnë për zgjidhjen e problemeve në rast të shkeljes apo cenimit të sigurisë kibernetike në komunikimet elektronike, duke shkëmbyer asistencë të specializuar.
- Të bashkëpunojnë në përgatitjen e Kodeve të Etikës për profesionistët e sigurisë së informacionit.
- Të bashkëpunojnë në dhënien e mendimeve të akteve ligjore e nënligjore, që kanë lidhje me sigurinë kibernetike në komunikimet elektronike.
- Të marrin pjesë në grupet e punës për hartimin e udhëzimeve të posaçme për mbrojtjen e përdruesve në internet.
- Të bashkëpunojnë në grupe pune për të dhënë mendime në hartimin e udhëzimeve në fushën e mbrojtjes kibernetike në komunikimet elektronike.
- Të bashkëpunojnë në kuadër projektesh për organizimin e seminareve të përbashkëta në mënyrë që të informohen dhe pajisen me materiale ndërgjegjësuese për mbrojtjen kibernetike.
- Të bashkëpunojnë për shkëmbimin e botimeve të ndërsjellta.
- Të bashkëpunojnë për shkëmbimin e ndërsjelltë të akteve vendimmarrëse, rekomandimeve, etj.

Neni 4 Komunikimi i palëve

- Palët angazhohen të mbajnë një komunikim të vazhdueshëm ndërmjet tyre dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e detyrave të tyre. Komunikimi do të kryhet në formë shkresore.
- Palët do të caktojnë një person kontakti me njohuri të specializuara të fushës që do të jetë përgjegjës për zbatimin konkret të Marrëveshjes së Bashkëpunimit.
- Përsonat e kontaktit nga të dyja palët do të jenë të disponueshëm në çdo kohë për komunikimin dhe koordinimin e veprimeve me palën tjetër.
- Me anë të përfaqësuesve të dyja palët do të përcaktojnë radhën e mbledhjeve të grupeve të punës, kohëzgjatjen dhe periodicitetin e këtyre mbledhjeve.

Neni 5 Ndryshime

Marrëveshja mund të ndryshohet vetëm me miratimin e ndërsjelltë me shkrim të Palëve.

Neni 6
Afat

Kjo marrëveshje lidhet me një afat të pacaktuar. Marrëveshja mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit me shkrim nga Pala tjetër. Deri në përfundimin e kësaj Marrëveshjeje, Palët do t'u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo Marrëveshje, përsa i përket informacionit dhe dokumenteve të shkëmbyera përpara datës së përfundimit të saj.

Neni 7
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Marrëveshja e sipërme do të hyjë në fuqi datën e nënshkrimit të saj nga titullarët e palëve. Nënshkruar në Tiranë, më datë 11.02.2014, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe dy të tjera në Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

PËR AUTORITETIN E KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE

KRYETARI

Z.PIRO XHIXHO

PËR AGJENCINË KOMBËTARE
PËR SIGURINË KOMPJUTERIKE

DREJTOR

Znj. ROVENA BAHITI